



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Ex officio

Rasti Nr. 355/2016

RAPORT ME REKOMANDIME

I AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

në lidhje me

Të drejtat civile të shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të zhvendosur në Republikën e Kosovës

Drejtuar:

Për: Z. Flamur Sefaj, Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Kopje për: Z. Ramush Haradinaj, Kryeministër

Prishtinë, më 16 mars 2018

Qëllimi i raportit

1. Ky raport ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve përgjegjëse shtetërore të Republikës së Kosovës lidhur me të drejtat civile për status dhe qëndrim ligjor dhe pajisje me dokumentacion personal të shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të shpërngulur në Kosovë.

Baza ligjore e veprimit të Avokatit të Popullit

2. Sipas nenit 135, par. 3 të Kushtetutës, “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”.

Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:

- “të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre” (pika 1);
- “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (pika 2);
- “të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (pika 4);
- “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (pika 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 6);
- “të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryej hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (pika 8);

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon të kryejë këto përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore.

Përshkrimi i rastit

3. Më 7 qershor 2016, Avokati i Popullit ka hapur rast për hetim sipas detyrës zyrtare, *ex officio* nr. 355/2016, bazuar në informatat e pranuar nga Lëvizja Qytetare “Vatra”, pasuar me informata plotësuese nga artikujt e gazetave ditore: Koha ditore, datë 10 janar 2017, me titull “Të zhvendosurit nga Lugina e Preshevës, në pritje të regjistrimit zyrtar”, Gazeta Zëri, datë 28 janar 2017 “Serbia mban peng të diplomuarit në Kosovë” dhe e njëjta me datë 19 janar 2017, me titull “Serbia si pranon, Kosova ua mohon shtetësinë”.
4. Nga viti 2001, një numër i konsideruar i shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, për arsye të ndryshme, janë shpërngulur në territorin e Republikës së Kosovës,

me përqendrim kryesisht në qytetin e Gjilanit, Fushë Kosovës dhe Prishtinës, përderisa numër i vogël i tyre janë shpërndarë nëpër qytete të tjera në Kosovë.

5. Në vitin 2011 Qeveria e Serbisë miratoi Ligjin për Qëndrim të Përhershëm dhe të Përkohshëm në Serbi, i publikuar në Gazetën Zyrtare të RS, Nr.87/2011, i cili ka hyrë në fuqi më 29.11.2011. Me këtë ligj rregullohet regjistrimi dhe çregjistrimi i qëndrimit të përhershëm dhe regjistrimi dhe çregjistrimi i qëndrimit të përkohshëm jashtë vendit, juridiksionin dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve të duhura.¹ Në kuptim të këtij ligji, të drejtën për banim të përhershëm në Republikën e Serbisë, e kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Serbisë që jetojnë në mënyrë të përhershme në territorin e Republikës së Serbisë.² Hyrja në fuqi e këtij ligji ndikoi negativisht dhe krijoi komplikime ndaj popullatës shqiptare të Serbisë lidhur me të drejtën e tyre për njohjen e identitetit para ligjit, përkatësisht pajisjen me dokumente personale si kartat e identitetit dhe pasaportat të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë. Rrjedhimisht, ky ligj i kushtëzon qytetarët me lëshimin e dokumenteve personale, duke iu kërkuar prova dhe duke bërë inspektime sipas nenit 18, nëse ata vazhdojnë të jetojnë në vendbanimin apo adresën e regjistruar.
6. Kjo çështje ka ringjallur problemet më komplekse në Republikën e Serbisë. Raporti i Komisionit Evropian për Serbinë i vitit 2015³ i referohet çështjes rreth shifrave të pasakta të numrit të popullsisë, që kanë rezultuar nga bojkotimi i regjistrimit të shqiptarëve në vitin 2011. Pra, bëhet fjalë për një numër të madh të qytetarëve të komunave Preshevë, Medvegje dhe Bujanoc, ndaj të cilave është ndërmarrë apo pritet të ndërmerret sanksioni i shlyerjes nga evidenca, përmes një aksioni të gjerë nga policia serbe, për të cilët sipas tyre vërtetohet se vazhdojnë të mos jetojnë në adresat e paraqitura, edhe pse bëhet fjalë për personat të cilët posedojnë nënshtetësinë e Republikës së Serbisë, kanë patundshmëri në ato komuna, dhe janë tatimpagues në këtë shtet. Personave, të cilët janë shlyer nga evidenca për arsyet e cekura më lartë, u refuzohet e drejta për pajisje me dokumentacion personal, me ç' rast ata privohen në realizimin e të drejtave të tyre elementare.
7. Sipas deklaratave të qytetarëve të prekur nga ky ligj, përkatësisht shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, dispozita ligjore e nenit 18 të Ligjit për Qëndrim të Përhershëm dhe të Përkohshëm në Serbi, e cila rregullon procedurat për regjistrimin dhe çregjistrimin e përhershëm dhe të përkohshëm të vendbanimit, është duke u zbatuar vetëm ndaj popullatës shqiptare, që aktualisht jeton në Kosovë. Shqiptarët e Preshevës, Medvegjes dhe Bujanocit e konsiderojnë këtë veprim të Republikës së Serbisë si veprim qartazi diskriminues.
8. Një numër i madh i qytetarëve të komunave në fjalë, të cilët janë shpërngulur në Kosovë, për arsye të sigurisë apo aspekteve sociale dhe ekonomike, në mungesë të dokumenteve personale, për një kohë të gjatë po përballën me çështje të mbetjes pa status dhe qëndrim ligjor, pa shtetësi efektive dhe dokumente personale identifikimi, brenda territorit të Republikës së Kosovës.

¹ Ligji për Qëndrim të Përhershëm dhe të Përkohshëm në Serbi, (*titulli original: O Prebivalistu i Boravistu Građana*), Nr. 87/2011, neni 1, http://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_prebivalistu_i_boravistu_gradjana.html

² Po aty, neni 2.

³ European Commission, "Commission Staff Working Document, Serbia 2015 Report", Faqe 58, gjindet në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_serbia.pdf.

9. Bazuar në informatat me të cilat Avokati i Popullit disponon, ende nuk ka statistika zyrtare apo ndonjë formë regjistrimi rreth numrit të saktë të shqiptarëve të shpërngulur nga Serbia në Kosovë, ndërsa nëse i referohemi informatave jo zyrtare është pohuar se janë diku rreth 3500 persona që nuk kanë asnjë dokument të Republikës së Kosovës.
10. Sipas informatave nga Lëvizja Qytetare “Vatra” drejtuar Avokatit të Popullit, këta pjesëtar që 17 vite nuk kanë arritur të pajisen me dokumentacion identifikimi të Republikës së Kosovës, dhe nuk kanë arritur ta fitojnë të drejtën e shtetësisë për shkak të mungesës së dokumentacioneve përkatëse të shtetit prej nga vijnë.
11. Më 7 qershor 2016, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, vizituan zyrën e divizionit për shtetësi në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, me ç’ rast diskutuan lidhur me problemet për fitimin e shtetësisë me natyralizim për të ardhurit nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci. Udhëheqësi i këtij divizioni njoftoi përfaqësuesin e IAP lidhur me situatën e krijuar rreth statusit ligjor dhe qëndrimin të tyre në vendin tonë.

Analiza ligjore dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

12. Vlerësimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit, lidhur me këtë çështje bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (Kushtetuta), Ligjet, Konventen Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokolet e saj (KEDNJ), dhe praktiken e Gjykatës Evropiane për të Drejtat Njeriut (GJEDNJ).
13. Sipas Kushtetutës, neni 22, të drejtat dhe liritë e njeriut janë të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, në veçanti me KEDNJ, e cila sipas kësaj dispozite është drejtëpërdrejtë e zbatueshme në Kosovë dhe ka prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
14. Neni 53, i Kushtetutës përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GJEDNJ.
15. Neni 21, i Kushtetutës garanton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.
16. Fitimi, humbja dhe rifitimi i të drejtës së shtetësisë së Republikës së Kosovës rregullohet Ligjin për Shtetësinë e Kosovës, Nr.04/L-215. Kriteret për aplikimin për fitimin e shtetësisë për të huajt, përcaktohen me këtë ligj. Ligji për të Huajt, Nr. 04/L-219, rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës. Bazuar në këtë ligj, çdo person fizik i cili nuk është shtetas i Republikës së Kosovës konsiderohet i huaj.
17. Neni 93 i Ligjit për të Huajt, përveç tjerash shprehimisht përcakton, si ne vijim: “1. Konsiderohet se i huaji qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikën e Kosovës atëherë kur: 1.1. nuk posedon vizë të vlefshme kur kërkohet për hyrje dhe qëndrim në Republikën e Kosovës; 1.3. nuk ka leje qëndrimi të vlefshme ose i është anuluar ose revokuar lejeqëndrimi; 1.5 gjendet duke punuar në kundërshtim me kushtet e parapara me këtë ligj ose ligjet tjera në fuqi”. Bazuar në këtë nen, ligjërisht personat të cilët janë duke jetuar në Kosovë, në rastin konkret të shpërngulurit nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, me mungesë të statusit civil, janë duke qëndruar në mënyrë të parregullt në Kosovë. Ky nen, në paragrafin 2, gjithashtu përcakton se: “I huaji i cili

qëndron në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës duhet që menjëherë ta lëshoj territorin e Republikës së Kosovës, përveç të huajt i cili ka aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare dhe është në pritje të vendimit për statusin e tij/saj”.

18. Termi “Qëndrimi i paligjshëm” në Ligjin për të Huajt të Kosovës, [Neni 3 – Përkufizimet, pika 1.10], definohet me kuptimin: “prezenca e të huajt në territorin e Republikës së Kosovës i cili nuk i plotëson, apo nuk i plotëson më kushtet për hyrje apo qëndrim në Republikën e Kosovës”. Teorikisht praktika e Bashkimit Evropian përkatësisht Komisioni Evropian, sot përkrah termin “qëndrim i parregull” në vend të atij “qëndrim i paligjshëm”. Të njëjtin term “qëndrim i parregull” e përdor edhe Republika e Shqipërisë, në Ligjin për të Huajt, Nr.108/2013, i definuar me këtë koncept: “Qëndrim i parregull - është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë”.
19. Rrjedhimisht, meqë një numër i tyre nuk posedojnë dokumente personale të vlefshme, për arsyet e cekura më lartë, të njëjtëve ju është bërë e pamundur t’i ndjekin procedurat për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës, pavarësisht qëndrimit mbi 15 vite. Kushtimisht, këta persona po përballen me mungesën e statusit të qëndrimit ligjor, pa shtetësi, qoftë të Serbisë apo edhe të Kosovës, të dy shtete këto të cilat ligjërisht e njohin shtetësinë e dyfishtë.
20. Avokati i Popullit e konsideron shqetësues faktin për mënyrën e qëndrimit dhe zhvillimit të jetesës për popullatën e Preshevës, Bujanocit, dhe Medvegjës, pasi që në mungesë të qëndrimit të tyre të rregullt në Republikën e Kosovës. Avokati i Popullit më tej vlerëson se ballafaqimi i tyre me vështirësi në realizimin e një jete normale dhe gëzimin e të drejtave elementare, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, është i pashmangshëm.
21. Më 6 qershor 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës, miratoi Rezolutën, Nr. 04-R-011, lidhur me të drejtat e shqiptarëve në, përmes së cilës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës të ketë më shumë përkujdesje dhe trajtim më të mirë për qytetarët shqiptarë të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës të cilët janë zhvendosë në Kosovë duke iu garantuar të drejta të plota dhe të barabarta.⁴ Përveç tjerash pika 4 e kësaj rezolute shprehimisht përcakton krijimin e lehtësirave për këtë komunitet: “Të krijohen lehtësi të qarkullimit,

⁴ Kuvendi i Republikës së Kosovës, 6 qershor 2013, Rezolutë, Nr. 04-R-011, Për të drejtat e shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë 1. Qeveria e Republikës së Kosovës të kushtëzojë marrëdhëniet me Serbinë, me kujdesin dhe interesimin shtetëror për përmirësimin e gjendjes së shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë lidhur me të drejtat e tyre civile, politike dhe etnike; 2. Qeveria e Republikës së Kosovës të ketë më shumë përkujdesje dhe trajtim më të mirë për qytetarët shqiptarë të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit, të cilët janë shpërngulur në Kosovë duke iu garantuar të drejta të plota dhe të barabarta; 3. Qeveria e Republikës së Kosovës të hapë një zyre në Prishtinë dhe në Gjilan për qytetarët e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me qëllim mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes dhe atyre të cilët janë shpërngulur nga atje sipas normave ndërkombëtare; 4. Të krijohen lehtësi të qarkullimit, shkollimit, afirmimit kulturor, pajisjeve me dokumente përkatëse si dhe lehtësi tjera, duke përfshirë suspendimin e taksës diskriminuese; 5. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkon nga institucionet ndërkombëtare dhe institucionet relevante që të liroj të burgosurit politikë duke përfshirë të ashtuquajturin grupin e Gjilanit që janë viktimat të një procesi të montuar politik; 6. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë reciprocitet të plotë me të drejtat e serbëve pakicë në veri të Kosovës; 7. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet nismën e themelimit të një Universiteti Publik në gjuhën shqipe dhe fton përfaqësuesit politikë dhe institucionalë të marrin nismë ligjore; 8. Kuvendi i Republikës së Kosovës mbështet themelimin e fondit zhvillimor për Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë me iniciativën e Qeverisë së Kosovës dhe në koordinim me institucionet ndërkombëtare dhe evropiane; 9. Kuvendi i Republikës së Kosovës fton Këshillin e Evropës dhe organizatat tjera ndërkombëtare që të angazhohen për detyrimin e Republikës së Serbisë për të respektuar të gjitha të drejtat që dalin nga Konventat ndërkombëtare; 10. Qeveria e Republikës së Kosovës të themelon grupin ndërmënyësor për implementim që përfshin edhe vizitën e mundshme të Komisionit Parlamentar për Integritet Evropian dhe Ministrisë për Integritet Evropian.

shkollimit, afirmimit kulturor, pajisjeve me dokumente përkatëse si dhe lehtësi tjera, duke përfshirë suspendimin e taksës diskriminuese.”

22. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në rastin Kurić dhe të Tjerë kundër Sllovenisë, gjeti shkelje të së drejtës për respektimin e “jetës private ose familjare” ose të djave (neni 8 i Konventës), të drejtën për zgjidhje efektive (neni 13) dhe ndalimin e diskriminimit (neni 14, i lexuar bashkë me nenin 8) në lidhje me fshirjen nga regjistri i banorëve të përhershëm nga autoritetet sllovene, me ç rast rezultoi me humbjen e statusit ligjor të kërkuesve: z. Kurić, znj. Mezga, z. Ristanović, z. Berisha, z. Ademi dhe z. Minić. Për pasojë, jo vetëm kërkuesit në këtë çështje, por gjithashtu edhe një numër i madh personash të tjerë ishin prekur dhe ende vazhdonin të prekeshin nga ajo masë. GJEDNJ gjeti që shkelja në thelb kishte filluar me dështimin e zgjatur të autoriteteve sllovene që të rregullonin statusin e qëndrimit të kërkuesve pas “fshirjes” së tyre të paligjshme nga regjistri i banorëve të përhershëm dhe për t’u ofruar atyre një zgjidhje të përshtatshme. Gjykata gjithashtu thotë se kërkuesit, mund të pretendojnë se janë “viktima”, sipas nenit 34 të Konventës, për shkeljet e përmendura të së drejtave të tyre që rrjedhin nga Konventa.⁵
23. GJEDNJ-ja ka vendosur se neni 8 i KEDNJ-së përmban garanci procedurale për të parandaluar ndërhyrjen arbitrare në të drejtën e jetës private dhe familjare. Kjo pikë ndikon dhe ndihmon personat të cilët pavarësisht se kanë hyrë vetëm në një shtet, kanë krijuar një jetë private dhe familjare. Parregullsitë në aspektet procedurale të procesit të vendimmarrjes sipas nenit 8 mund të rezultojnë si shkelje të paragrafit 2 të këtij neni.⁶
24. Nga respektimi efektiv i jetës familjare mund të rrjedhin detyrime pozitive, dhe kjo veçanërisht në rastin e emigrantëve afatgjatë dhe dallimi në trajtim mes të huajve të cilët kanë një shtetësi të caktuar nga ata që nuk e kanë, përbën diskriminim në kundërshtim me Nenin 14 të KEDNJ-së në lidhje me nenin 8.⁷
25. Masat afirmative dhe masat pozitive për veprim (*apo termi i përdorur “diskriminimi pozitiv”*) definojnë lidhur me një bazë të caktuar për diskriminim, dhe me një qëllim konkret të promovimit të barazisë. Në rastet e diskriminimit të drejtpërdrejtë, arsyeja e ndodhjes së tij është për shkak të faktit se i njëjti rregull zbatohet për të gjithë pa marrë në konsideratë ndryshimet përkatëse. Për të korrigjuar dhe parandaluar këtë lloj situate, qeveritë duhet të garantojnë që të ndërmarrin hapa për korrigjimin e rregullave dhe praktikave të tyre për marrjen në konsideratë të ndryshimeve të tilla, që do të thotë se duhet të përshtaten masat dhe politikat aktuale. Në kontekstin e Kombeve të Bashkuara, këto janë të etiketuara “masa të posaçme”, ndërsa konteksti i të drejtës së BE-së i referohet “masat specifike” ose “veprimet pozitive”. Me marrjen e masave të posaçme, qeveritë janë në gjendje të garantojnë “barazinë reale”, d.m.th. gëzimin e barabartë të mundësive për përfitimet e disponueshme në shoqëri, dhe jo thjesht “barazi formale”. Në rast se nuk merren në konsideratë masa të posaçme, rritet rreziku që rregullat dhe praktikat aktuale të përbëjnë diskriminim të tërthortë.⁸ Masat e ndërmarra për përshtatje të arsyeshme nuk mund të konsiderohen si trajtim i paarsyeshëm dhe i pabarabartë. Është e kundërta, pasi që mungesa e masave të këtilla mund të konsiderohet si diskriminim.

⁵ GJEDNJ, Vendim, Kurić dhe të Tjerë kundër Sllovenisë, (lënda nr.26828/06), Stranbourg, 12.03.2014.

⁶ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja Kuric kundër Sllovenisë, datë 12 mars 2014, nr. aplikimi 26828/06.

⁷ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, çështja Benheba kundër Francës, datë 10 korrik 2003, nr. aplikimit 53441/99.

⁸ Këshilli i Evropës, *Manual për Ligjin Evropian të Mbrojtjes nga Diskriminimi*, fq. 28, korrik 2010.

26. GJEDNJ ka deklaruar se “e drejta për të mos u diskriminuar kundër gëzimit të të drejtave të garantuara sipas KEDNJ-së shkelet gjithashtu kur shtetet nuk i trajtojnë në mënyra të ndryshme personat, situatat e të cilëve janë shumë të ndryshme”.⁹
27. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në neni 6 shprehimisht përcakton se, secili ka të drejtë që të pranohet çdo kund si subjekt juridik përpara ligjit. Ndërsa në nenet 15.1 dhe 15.2 të kësaj deklarate shprehimisht përcaktohet se gjithkush ka të drejtën e një shtetësie, dhe askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga shtetësia e tij, e as nga e drejta për të ndërruar shtetësinë.
28. Një sistem funksional i regjistrimit civil është një instrument i rëndësishëm në sigurimin e të drejtave njerëzore vendore dhe atyre ndërkombëtare. Regjistrimi civil kontribuon në shumë mënyra për funksionimin normal të shoqërisë. Nëse shteti e konsideron të rëndësishme përmirësimin e organizimit familjar në mënyrë që të garantojë rendin shoqëror; për të garantuar të drejtat e njeriut; për të promovuar shëndetin publik dhe për të vënë në dispozicion informacion më të mirë mbi bazën e planifikimit dhe zhvillimit, duhet gjithashtu të konsiderojë përmirësimin e regjistrimit civil një çështje të rëndësishme dhe të ngutshme.
29. Bazuar në të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara nga kapitulli II i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe të drejtat e garantuara të dala nga Instrumentet ndërkombëtare¹⁰ drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, çdokush ka të drejtë, përveç tjerash: për identitetin personal, lirinë e lëvizjes, të drejtën për arsimin, mbrojtjen e pronës, të drejtën e martesës dhe familjes, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, të drejtat e fëmijës, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, të drejtat civile dhe politike, mbrojtjen gjyqësore të të drejtave, etj. ushtrimi i të cilave varet direkt nga regjistrimi civil dhe statusi i qëndrimit i rregulluar me ligj. Mungesa e përmbushjes së detyrimit shtetëror për rregullimin e statusit të qëndrimit ligjor, për qytetarët nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të shpërngulur në Kosovë, i privon ata drejtpërdrejtë nga gëzimi i të drejtave elementare të njeriut të listuara më lartë.
30. Bazuar në konsensusin universal, Agjenda 2030 e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm,¹¹ në kuadër të qëllimit 16,¹² objektivi 9 shprehimisht përcakton: “Deri në vitin 2030, të sigurohet identiteti ligjor për të gjithë”. Sipas këtij konsensusi, statistikat vitale janë një komponent thelbësor për monitorimin e zbatimit të Agjendës 2013 dhe

⁹ GJEDNJ, *Thlimenos kundër Greqisë* [GC] (No. 34369/97), 6 prill 2000, paragrafi 44 (Nr. 34369/97). Po ashtu, GJEDNJ, *Priti kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Nr. 2346/02), 29 prill 2002, paragrafi 88.

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22, Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare, Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollin e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Më të Rënda, Jonjerezore dhe Poshtëruese.

¹¹ Në shtator të vitit 2015, liderët botërorë miratuan agjendën e 2030 për zhvillim të qëndrueshëm. Kjo agjendë përfshin 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) dhe 169 nën objektiva që duhet të arrihen deri në vitin 2030. Kjo është një thirrje universale për veprim, për t'i dhënë fund varfërisë, për të mbrojtur planetin dhe për të siguruar që të gjithë njerëzit të gëzojnë paqe dhe prosperitet. Edhe pse Kosova nuk është anëtare e Asamblesë së Përgjithshme të OKB, ajo është bashkuar me përpjekjet globale për t'i dhënë fund të gjitha formave të varfërisë, për të luftuar pabarazitë dhe për të trajtuar çështjet mjedisore me partnerët rajonalë. Lista e Qëllimeve dhe Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm nga Agjenda 2030: <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/11803Official-List-of-Proposed-SDG-Indicators.pdf>

¹² Objektivi 16 përcakton “Të nxiten shoqëritë paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, të sigurohet qasje në drejtësi për të gjithë dhe të ndërtohen institucione efektive, përgjegjëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet”.

vlerësimin e progresit në zbatimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm. Sipas rekomandimeve të Kombeve të Bashkuara, dhënë në këtë nismë globale, sistemi i statistikave të rregullta, të besueshme dhe të sakta varet nga regjistrimi i plotë civil dhe raportimi i ndodhjes së të gjitha ngjarjeve vitale. Roli i regjistrimit civil shkon përtej burimit të statistikave vitale, pasi është thelbësore për të siguruar identitetin ligjor dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

31. Fryma për zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut është se këto nuk i gëzojnë vetëm një pjesë e kufizuar e qytetarëve të një shteti. Ato janë të vlefshme për çdo individ, pavarësisht nga kombësia apo shtetësia, si azilkërkuesit, refugjatët, punëtorët emigrantë dhe persona të tjerë, që ndodhen në territorin e një shteti tjetër ose janë nën juridiksionin e tij.

Në bazë të këtyre konstatimeve, dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 16, paragrafi 4 dhe nenin 18 paragrafi 1, nën-paragrafët. 1.2, 1.4 dhe 1.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit Nr. 05/L-019, Avokati i Popullit rekomandon Qeverinë e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrinë e Punëve të Brendshme që:

- 1. Të bëhet profilizimi i numrit të saktë të qytetarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të cilët po qëndrojnë pa status të definuar juridik në territorin e Republikës së Kosovës.*
- 2. Të ndërmerren masat e nevojshme për rregullimin e kuadrin ligjor, që u mundëson këtyre qytetarëve të gëzojnë të drejtat themelore dhe elementare të njeriut.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,


Hilmi Jashari
Avokat i Popullit